



Në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/2003, nen 6 dhe nen 14, Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2024 miraton

STATUTIN E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËRKUFIZIMI I OBJEKSTIT TË RREGULLIMIT TË STATUTIT

Neni 1 Përkufizimi

- Ky Statut përcakton organizimin e brendshëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Akademia), mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe të organeve të punës dhe të qeverisjes së Akademisë.
- Çështjet e tjera që nuk rregullohen me këtë Statut përcaktohen me rregulloret e veçanta të Akademisë.

Neni 2

Themelimi dhe statusi

- Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Kosovë, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.
- Dita e themelimit të Akademisë është 20.12.1975.
- Republika e Kosovës siguron kushte për punë dhe zhvillim të Akademisë.
- Akademia është institucion i pavarur në fushën e shkencës dhe të artit.

Neni 3 Veprimtaria

- Veprimtaria e Akademisë është veprimtari e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës.
- Interesi i veçantë publik i Akademisë shprehet në ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e shkencës dhe të artit, që përfshin promovimin, kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike.

Neni 4

Selia, emblema, vula dhe shkurtesa e Akademisë

- Selia e Akademisë është në Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, nr. 305.
- Akademia e ka emblemën e vet.
- Akademia e ka vulën e vet të rrumbullakët me tekstin në gjuhën shqipe dhe latine: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Academia Scientiarum et Artium Kosoviensis - Prishtinë. Në mes të vulës është emblema e Akademisë me vitin e themelimit të saj.
- Shkurtesa e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është ASHAK.

Neni 5

Subjektiviteti juridik

1. Akademia është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë Statut dhe me aktet e brendshme të saj.
2. Akademia ka të drejtë të krijojë marrëdhënje me persona të tjera publikë dhe privatë në bazë të ligjeve në fuqi.
3. Akademia disponon të drejtën e shfrytëzimit të donacioneve e granteve dhe burimeve të tjera të ligjshme financiare, dhe në marrëveshje me bartësit e projekteve shfrytëzimin e të hyrave vetanake të krijuara mbi bazën e projekteve hulumtuese shkencore, vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 6

Bashkëpunimi

Për realizimin e funksioneve të saj Akademia bashkëpunon me institucione shkencore dhe akademike të arsimit të lartë, institute shkencore, entitete ekonomike, agjenci shtetërore si dhe me punëtorë e hulumtueshëm nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të artit brenda dhe jashtë vendit.

Neni 7

Financimi i Akademisë

1. Puna e Akademisë financohet nga:
 - 1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Mjetet e fituara nga realizimi i projekteve shkencore; dhe
 - 1.3. Donacionet, grantet dhe burimet e tjera të ligjshme.

II. DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 8

Qëllimi i Akademisë

1. Qëllimi i Akademisë është zhvillimi, nxitja, promovimi dhe avancimi i shkencës dhe i artit në Kosovë, nëpërmjet:
 - 1.1. Realizimit të projekteve shkencore me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit;
 - 1.2. Kujdesit për krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore, sidomos të brezit të ri;
 - 1.3. Mbledhjes, sistemimit, ruajtjes dhe studimit të materialeve me interes të veçantë shkencor, sidomos të atyre që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe të kaluarën e Kosovës;
 - 1.4. Pjesëmarrjes në formimin e politikave të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
 - 1.5. Vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit shkencor dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike;
 - 1.6. Shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
 - 1.7. Organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes dhe të arteve përmes tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, konferencave shkencore dhe formave përkatëse të shprehjes së

krijimtarisë artistike, si ekspozitave, koncertereve, etj.;

- 1.8. Botimit të publikimeve të rregullta dhe periodike nga fusha e shkencës dhe e artit, që financohen nga buxheti i Akademisë;
- 1.9. Bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës dhe me institucionet ndërkontaktare nga fusha e shkencës dhe e artit;
- 1.10. Ndihmës për përhapjen e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike jashtë vendit;
- 1.11. Përmirësimi të vazhdueshëm të kushteve të punës të anëtarëve të Akademisë;
- 1.12. Zhvillimit të hulumtimeve me interes të veçantë publik e shkencor; dhe
- 1.13. Ndërmarrjes së veprimeve në interes të veçantë për Kosovën, në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Akademisë për të qenë institucion këshillues për zhvillimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

Neni 9 Detyrat e Akademisë

1. Detyrat e Akademisë janë:
 - 1.1. Planifikimi i punës kërkimore-shkencore dhe artistike në përputhje me mundësitet e saj për realizimin e tyre;
 - 1.2. Pranimi i anëtarëve të rinj në përputhje me standartet më të larta të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike;
 - 1.3. Bashkëpunimi i rregullt me institucionet e Republikës së Kosovës, akademitë simotra jashtë vendit si dhe me organizatat shkencore ndërkontaktare me qëllim të komunikimit të ndërsjellë shkencor e artistik dhe të integrimit në rrjetet botërore të shkencës dhe të artit;
 - 1.4. Realizimi i projekteve me qëllim të ndërtimit të strategjive të zhvillimit të gjithmbarshëm të vendit;
 - 1.5. Puna në projekte të përbashkëta me institucionet e ngjashme, me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe të zhvillimit të vlerave kulturore e trashëgimive gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës;
 - 1.6. Puna në projekte të përbashkëta për studimin dhe zhvillimin e kulturave në Kosovë;
 - 1.7. Puna në projekte të përbashkëta për studimin e resurseve natyrore që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të vendit; dhe
 - 1.8. Kryerja e aktiviteteve të tjera që përcaktohen me këtë Statut dhe me aktet e tjera normative të Akademisë.

III. ORGANIZIMI I AKADEMISË

Neni 10 Organizimi

Me qëllim të avancimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike me interes të përgjithshëm për shkencën dhe për artin në Kosovë, Akademia themelon seksione, institute hulumtuese dhe gendra studimore.

Neni 11
Sekcionet e Akademisë

1. Akademia përbëhet nga këto seksione:
 - 1.1. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë;
 - 1.2. Seksioni i Shkencave Shoqërore;
 - 1.3. Seksioni i Shkencave të Natyrës; dhe
 - 1.4. Seksioni i Arteve.
2. Sekcionet janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive të Akademisë për fushat shkencore e artistike për të cilat janë themeluar.
3. Në sektionet e Akademisë veprojnë anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë të fushave përkatëse shkencore e artistike.
4. Në fushëveprimin e sektioneve bëjnë pjesë shkencat dhe artet që përcaktojnë emërtimin e sektionit.
 - 4.1. Nëse ndonjëri prej sektioneve të Akademisë, për arsyet objektive nuk mund të ushtrojë funksionet e tij, Kryesia me vendim të veçantë themelon një komision të përkohshëm, i cili ushtron të gjitha funksionet e tij, deri sa të krijohen kushtet për funksionalitetin e sektionit përkatës.
5. Sekcionet formohen, bashkohen, ndahen dhe shuhën në pajtim me këtë Statut.

Neni 12
Detyrat e sektioneve

1. Sekcionet kryejnë këto detyra:
 - 1.1. Zgjedhin sekretarin e sektionit që miratohet nga Kuvendi;
 - 1.2. Organizojnë punën shkencore a artistike nga fushëveprimitaria e tyre dhe hartojnë plane, programe dhe raporte të punës, të cilat ia paraqesin Kuvendit të Akademisë;
 - 1.3. Organizojnë konferanca, tryeza, kolegjiume, debate, ekspozita, koncerte dhe aktivitete të tjera të karakterit shkencor ose artistik nga fushëveprimitaria e tyre;
 - 1.4. I propozojnë Kuvendit kandidatë për anëtarë të rregullt dhe për anëtarë korrespondentë të Akademisë nga fushat përkatëse;
 - 1.5. I propozojnë Kryesisë kandidatë për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit të Akademisë nga fushat përkatëse;
 - 1.6. I propozojnë dhe i paraqesin për miratim Kryesisë kandidatë për laureatë nga fushëveprimitaria e tyre;
 - 1.7. Caktojnë recensentët profesionalë për punimet nga fushëveprimitaria e tyre që bodojnë nga Akademia;
 - 1.8. Caktojnë recensentët për shqyrtimin dhe hartimin e propozimeve për pranimin e kandidatëve për anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë të Akademisë;
 - 1.9. Caktojnë redaktorët për botimet e veta në rastet kur vet sekretari i sektionit është autor i dorëshkrimit; dhe
 - 1.10. Kryejnë edhe punë të tjera nga fushëveprimitaria e tyre.

Neni 13
Marrja e vendimeve

1. Seksioni merr vendime në mbledhje.
2. Për vendosje është e nevojshme që në mbledhje tëjenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të sektionit.

3. Seksioni merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të tij.
4. Seksioni në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsyet tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e seksionit.
5. Në mbledhjet e seksionit mbahet procesverbal.

Neni 14
Sekretari i seksionit

1. Punën e seksionit e drejton Sekretari i seksionit.
2. Sekretari i seksionit:
 - 2.1. Zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt ose anëtarëve korrespondentë;
 - 2.2. Zbaton vendimet e seksionit;
 - 2.3. Kujdeset për organizimin e punës dhe kryerjen e detyrave të seksionit;
 - 2.4. Përgatit dhe thërrret mbledhjet e seksionit;
 - 2.5. Kryeson mbledhjet e seksionit;
 - 2.6. Informon Kryesinë dhe Kuvendin për punën e seksionit;
 - 2.7. Përfaqëson seksionin në organet e Akademisë;
 - 2.8. Informon seksionin mbi konkluzat dhe propozimet e organeve të Akademisë;
 - 2.9. Redakton botimet e rregullta të seksionit;
 - 2.10. Thërrret mbledhjet sipas nevojës; dhe
 - 2.11. Thërrret mbledhjet edhe me propozimin e arsyetuar të së paku gjysmës së anëtarëve të seksionit.
3. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit të seksionit, seksioni me vendim të veçantë cakton një anëtar të tij ushtrues detyre të Sekretarit të seksionit.
 - 3.1. Nëse asnjëri nga anëtarët e seksionit nuk i plotëson kushtet për t'u caktuar ushtrues detyre i Sekretarit të seksionit, në pajtim me nenin 11, pika 4.1, komisioni i përkohshëm i propozon Kryesisë një anëtarë të Akademisë ushtrues të përkohshëm të detyrës së Sekretarit të seksionit.

Neni 15
Institutet hulumtuese dhe Qendrat studimore

1. Institutet hulumtuese dhe qendrat studimore themelohen nga Kuvendi me propozimin e Kryesisë.
2. Inicimin për themelin e Instituteve hulumtuese dhe qendrave studimore e bëjnë seksionet.
3. Punën e instituteve hulumtuese dhe të qendrave të tjera studimore e drejton drejtori ose organi përkatës drejtues.
4. Puna e instituteve hulumtuese dhe e qendrave studimore rregullohet me Rregullore të veçantë të cilën e nxjerr Kuvendi.

Neni 16
Aktivitetet e Akademisë

1. Akademia, përkatësisht seksionet, institutet hulumtuese dhe qendrat studimore të saj mund të jenë organizues ose bashkorganizues të aktiviteteve shkencore dhe artistike.
2. Aktivitetet shkencore dhe artistike të Akademisë përfshijnë:

- 2.1 Tubimet shkencore;
- 2.2 Koncertet;
- 2.3 Ekspozitat;
- 2.4 Ligjëratat;
- 2.5 Promovimet; dhe
- 2.6 Aktivitetet e tjera të cilat përcaktohen nga Kryesia e Akademisë me vendim të veçantë.

Neni 17
Veprimtaria botuese

1. Veprimtaria botuese përfshin botimet e rregullta dhe të veçanta të Akademisë.
2. Veprimtaria botuese rregullohet me rregullore të veçantë, të cilën e nxjerr Kuvendi.

IV. ANËTARËT E AKADEMISË

Neni 18
Anëtarët

1. Akademia ka anëtarë të rregullt - akademikë, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi.
2. Të qenit anëtar i Akademisë është i përjetshëm.
3. Akademia nuk ka numër të kufizuar të anëtarëve të vet.
4. Anëtarë korrespondentë të Akademisë zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeçare.
 - 4.1. Kandidatët të cilët në ditën e mbylljes së afatit për paraqitjen e propozimeve mbushin 65 vjeç nuk mund të hyjnë në procedurën e zgjedhjeve;
 - 4.2. Afati i mbylljes së paraqitjes së propozimeve përcaktohet me *Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë* (në tekstin e mëtejmë: Qarkorja); dhe
 - 4.3. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit të cekur në nënparagrafin 4.1 të këtij nenii, nuk do të merren parasysh.
5. Anëtarë i rregullt dhe anëtarë korrespondent i Akademisë mund t'i takojë vetëm një seksioni.
6. Anëtarët e Akademisë janë anëtarë të atij seksioni të cilit i përket shkenca respektivisht arti me të cilin merren.

Neni 19
Anëtarë i rregullt

1. Anëtar i rregullt i Akademisë zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit për të arritura të veçanta në fushën e shkencës ose të artit.
2. Titullin Akademik e bartë vetëm anëtarë i rregullt i Akademisë.
3. Anëtar i rregullt i Akademisë zgjidhet shtetasi i Kosovës që është punonjës i shqar i shkencës ose i artit që ka arritje shkencore dhe artistike, veprat e të cilit paraqesin realizime kulmore në fushën e shkencës ose të artit dhe janë me peshë në vend dhe jashtë tij.
4. Anëtar i rregullt zgjidhet anëtarë korrespondent rezultatet e punës së të cilit që nga zgjedhja anëtar korrespondent paraqesin një arritje të lartë në fushën e shkencës ose të artit dhe që gjëzojnë një njojje të përgjithshme.

Neni 20

Anëtar korrespondent

Anëtar korrespondent i Akademisë zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit, shtetas i Kosovës, i cili ka krijuar vepra shkencore ose artistike të një rëndësie të veçantë.

Neni 21

Anëtar i jashtëm

1. Anëtar i jashtëm i Akademisë zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit që jeton dhe vepron jashtë vendit, e i cili ka krijuar vepra të rëndësishme për Kosovën, ose me vlerë të përgjithshme për shkencën ose artin.
2. Anëtarit të jashtëm të Akademisë i pranohet statusi i anëtarit korrespondent, nëse:
 - 2.1. Ka shtetësi të Republikës së Kosovës;
 - 2.2. Ka vendbanim të përhershëm në Kosovë të dëshmuar me dokumente përkatëse;
 - 2.3. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së paku dy mandate; dhe
 - 2.4. Ka pasur bashkëpunim të përhershëm shkencor dhe artistik me Akademinë, përmes botimeve, pjesëmarrijes në tubime shkencore dhe artistike dhe formave të tjera.
3. Procedura e ndryshimit të statusit nga anëtar i jashtëm në anëtar korrespondent mund të fillojë vetëm me kërkesë të kandidatit drejtuar Kryesisë së Akademisë.
4. Për kalimin nga statusi anëtar i jashtëm në anëtar korrespondent kandidati duhet t'i shtrohet procedurës së votimit në seksionin përkatës dhe zgjedhjes në Kuvendin e Akademisë.
5. Pas zgjedhjes në Kuvend, anëtarët e jashtëm i gjelqjnë të gjitha të drejtat dhe i marrin të gjitha përgjegjësitë e parapara me Ligjin për Akademinë, me këtë Statut dhe me aktet e tjera normative.

Neni 22

Anëtar nderi

1. Anëtar nderi i Akademisë mund të zgjidhet krijuesi i shquar i shkencës ose i artit, ose humanisti i shquar që nuk është shtetas i Kosovës, i cili me veprën e tij është bërë përgjithësisht i njohur për shkencën, artin ose për vlerat humaniste universale, dhe i cili ka dhënë kontribut për Kosovën.

Neni 23

Procedura e propozimit të anëtarëve të Akademisë

1. Kryesia me vendim të veçantë shpall zgjedhjet për anëtarë të Akademisë dhe miraton Qarkoren.
2. Kryesia pas përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve i shqyrton propozimet e arritura në Akademi:
 - 2.1. Afati i paraqitjes së propozimeve për anëtarë korrespondentë të Akademisë përcaktohet në Qarkore; dhe
 - 2.2. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit të përcaktuar në nënparagrin 2.1. të këtij paragrafi nuk merren parasysh.
3. Seksionet e Akademisë i paraqesin propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
4. Këshillat e fakulteteve të universiteteve publike dhe këshillat shkencore të instituteve shkencore publike, që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës i paraqesin

propozimet pér zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë të Akademisë.

5. Kryesia e Akademisë i propozon dhe i paraqet Kuvendit propozimet e veta dhe propozimet e miratuara të seksioneve pér zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit.
6. Propozimet e recensentëve duhet tē jenë tē arsyetuara me shkrim dhe duhet tē përbajnë:
 - 6.1. Tē dhënat e hollësishme pér punën shkencore dhe pér veprat artistike të kandidatit të propozuar;
 - 6.2. Vlerësimet e plota të propozuesve pér rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar; dhe
 - 6.3. Tē dhënat pér recensionet e mëparshme të rezultateve të krijimtarisë shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.
7. Propozimet pér zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë u dërgohen seksioneve përkatëse që ato tē shfaqin mendimet e tyre pér secilin kandidat.
8. Mendimin e tyre pér kandidatët seksionet e shfaqin në bazë të recensioneve të më së paku dy anëtarëve të vet.
9. Pér zgjedhjen e anëtarëve të rregullt recensionet i paraqesin anëtarët e rregullt.
10. Pér zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë recensionet i paraqesin të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.
11. Pér zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit të Akademisë recensionet i paraqesin të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.
12. Recensionet e propozimeve pér zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë u lihen në dispozicion opinionit pér shtatë ditë dhe pér këtë nxirret njoftimi në mjetet e informimit.
13. Vërejtjet eventuale i paraqiten Kryesisë së Akademisë me shkrim dhe të nënshkruara.

Neni 24

Procedura e zgjedhjes dhe e votimit të anëtarëve të Akademisë

1. Anëtarët e Akademisë zgjidhen nga Kuvendi i Akademisë në seancë zgjedhore.
2. Seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë në tē cilën bëhet zgjedhja e anëtarëve të rregullt dhe anëtarëve korrespondentë, e anëtarëve të jashtëm dhe e anëtarëve të nderit të Akademisë, caktohet nga Kryesia e Akademisë së paku tre muaj para mbajtjes së saj.
3. Zgjedhjet pér anëtarë tē Akademisë bëhen pér çdo katër (4) vjet.
4. Anëtar i rregullt zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Akademisë.
5. Anëtar korrespondent zgjidhet me shumicën e votave të tē gjithë anëtarëve të rregullt dhe tē anëtarëve korrespondentë tē Akademisë.
6. Anëtar i jashtëm dhe anëtar i nderit zgjidhen me shumicën e votave të tē gjithë anëtarëve të rregullt dhe tē anëtarëve korrespondentë tē Akademisë.
7. Seanca zgjedhore në tē cilën zgjidhen anëtarët e Akademisë mbahet nëse në tē është e pranishme shumica e anëtarëve tē Akademisë.
8. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve tē Akademisë rregullohet me rregullore tē veçantë.

Neni 25

Të drejtat dhe defyrat e anëtarëve të Akademisë

1. Anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë tē Akademisë kanë defyra e përgjegjësi tē përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut, e posaçërisht:
 - 1.1. Tē marrin pjesë në veprimtarinë shkencore dhe artistike tē Akademisë;
 - 1.2. Tē zgjedhin dhe tē zgjidhen në organet e Akademisë;
 - 1.3. Tē përfaqësojnë Akademinë kur u besohet kjo punë;

- 1.4. Të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit dhe të seksioneve që u përkasin; dhe
- 1.5. Të kryejnë edhe detyra të tjera nga plani e programi i punës së Akademisë.
2. Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Akademisë pezullohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë për kohën, mbi një vit, që ai nuk jeton dhe nuk vepron në Kosovë.

Neni 26
Shpërblimet

1. Anëtarit të rregullt dhe anëtarit korrespondent të Akademisë me qëndrim të përhershëm në vend, i takon shpërblimi i përhershëm mujor.
2. Lartësia e shpërblimit për anëtarin e rregullt dhe anëtarin korrespondent të Akademisë bazohet në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/211, datë 16 gusht 2006 dhe do të ndryshojë në varësi të vendimeve për lartësinë e pagave të profesorëve të rregullt dhe të asocuar universitarë.
3. Anëtarëve të Kryesisë u takon shtesa mujore përfunkcionet që i kryejnë.
4. Kriteret dhe lartësia e shtesave mujore të anëtarëve të Akademisë përfunkcionet që i kryejnë në Akademi përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Anëtarëve të Akademisë u takon shpërblimi përkatës mujor edhe përgjashtë muaj pas vdekjes.
6. Anëtarëve të Akademisë që nuk marrin pjesë në aktivitetet e Akademisë më tepër se një vit pa arsy me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë u humb e drejta e shpërblimit.

Neni 27
Pushimi i statusit të anëtarit të Akademisë

1. Të qenit anëtar i Akademisë pushon:
 - 1.1. Me kërkesën nga vetë anëtar i Akademisë;
 - 1.2. Nëse heq dorë nga shtetësia e Kosovës; dhe
 - 1.3. Me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë, nëse me sjelljet e tij shkel dinjitetin e anëtarit të Akademisë.

V. ORGANET DHE UDHËHEQJA E AKADEMISË

Neni 28
Organet e Akademisë

Organet e Akademisë janë: **Kuvendi, Kryesia dhe Kryetari.**

Neni 29
Kuvendi i Akademisë

1. Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i Akademisë.
2. Kuvendin e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë.
3. Në punën e Kuvendit të Akademisë mund të marrin pjesë edhe anëtarët e jashtëm të saj, pa të drejtë vote.
4. Seanca e Kuvendit të Akademisë thirret nga:
 - 4.1 Kryesia e Akademisë;
 - 4.2 Më së paku dy (2) seksione të Akademisë; dhe
 - 4.3 Dhjetë (10) anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë të Akademisë.

5. Seancat e Kuvendit mund tē jenē tē rregullta, tē jashtëzakonshme dhe zgjedhore.
6. Seancat e rregullta mbahen sē paku dy herë nē vit.
7. Seancën e rregullt e thërret Kryesia mē sē paku 15 ditë para mbajtjes sē saj.
8. Seancën e jashtëzakonshme e thërret Kryesia sipas nevojës sē paku 8 ditë para mbajtjes sē saj ose kur këtë e kërkojnë sē paku dy seksione ose dhjetë (10) anëtarë tē rregullt dhe anëtarë korrespondentë tē Akademisë.
9. Seanca zgjedhore nē tē cilën zgjidhet Kryetari, Nënkyetari, Sekretari shkencor dhe nē tē cilën miratohet zgjedhja e sekretarëve tē seksioneve, mbahet çdo katër vjet dhe thirret nga Kryesia sē paku 30 ditë para mbajtjes sē saj.
10. Seanca zgjedhore nē tē cilën zgjidhen anëtarët e Akademisë mbahet çdo katër vjet dhe thirret nga Kryesia sē paku tre muaj para mbajtjes sē saj.
11. Në seancat e Kuvendit vendimet merren me shumicën e votave tē tē gjithë anëtarëve tē Akademisë.
12. Në seancat e rregullta dhe tē jashtëzakonshme vendoset pér mënyrën e votimit, ndërsa nē seancat zgjedhore votimi eshtë i fshehtë.
13. Kuvendi i Akademisë mund tē mblidhet dhe tē vendosë me praninë e shumicës tē tē gjithë anëtarëve tē Akademisë.
14. Kuvendi nē mbledhjen përkatëse mund tē vendosë që nē kuorum tē mos përfshihen anëtarët tē cilët pér shkak tē sëmundjes sē gjatë ose pér ndonjë arsyet tjetër janë tē penguar tē marrin pjesë nē punën e Akademisë.

Neni 30

Detyrat dhe përgjegjësitet e Kuvendit

1. Detyrat dhe përgjegjësitet e Kuvendit tē Akademisë përfshijnë:
 - 1.1. Miratimin e Statutit tē Akademisë, me dy tē tretat e votave tē tē gjithë anëtarëve tē Akademisë;
 - 1.2. Miratimin e udhëzimeve, tē rregulloreve dhe tē akteve tē tjera normative tē Akademisë;
 - 1.3. Miratimin e buxhetit vjetor, tē planit financiar dhe tē llogarive përfundimtare tē Akademisë;
 - 1.4. Miratimin e programit tē punës sē Akademisë;
 - 1.5. Miratimin e raportit tē punës tē Akademisë;
 - 1.6. Miratimin e zgjedhjes sē sekretarëve tē seksioneve tē Akademisë;
 - 1.7. Zgjedhjen e anëtarëve tē rregullt, tē anëtarëve korrespondentë, tē anëtarëve tē jashtëm dhe tē anëtarëve tē nderit tē Akademisë;
 - 1.8. Themelimin e seksioneve, tē instituteve hulumtuese dhe tē qendrave studimore; dhe
 - 1.9. Obligimet e tjera që përcaktohen me ligjin pér Akademinë dhe me këtë Statut.

Neni 31

Kryesia e Akademisë

1. Kryesinë e Akademisë e përbëjnë: Kryetari, Nënkyetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve tē Akademisë.
2. Kryesia e Akademisë e bashkërendon punën e përgjithshme nga fusha e përgjegjësive tē saj.
3. Kryesia e Akademisë pér punën e vet i përgjigjet Kuvendit tē Akademisë.
4. Kryesia e Akademisë i zbaton vendimet dhe qëndrimet e Kuvendit.
5. Anëtarët e Akademisë mbi moshën shtatëdhjetë e pesë (75) vjeçare nuk mund tē ushtrojnë

funksione udhëheqëse (Kryetar, Nënkyetar, Sekretar shkencor dhe sekretar i sektionit):

- 5.1. Anëtarëve të Akademisë që ushtrojnë funksione udhëheqëse ditën që mbushin moshën 75 vjeç u ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës;
- 5.2. Procedura e zëvendësimit të anëtarëve të Akademisë në funksione udhëheqëse nis tre muaj para skadimit të mandatit në këto funksione; dhe
- 5.3. Anëtarët e Akademisë që zgjidhen në vende udhëheqëse nëpërmjet procedurës së zëvendësimit, në rastet e skadimit të mandatit sipas nënparagrait 5.1. të këtij neni, ushtrojnë mandatin e mbetur deri në zgjedhjet e reja sipas nënparagrait 5.2 të këtij neni.
6. Anëtarët e Akademisë që ushtrojnë funksione politike dhe shtetërore nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse në Akademi.
 - 6.1. Funksione politike dhe shtetërore konsiderohen: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, Ministri, Zëvendësministri, Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Kryetari i Komunës dhe Kryetari i partisë.
7. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katër vjeçare (4) me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Neni 32

Kompetencat e Kryesisë së Akademisë

1. Kryesia e Akademisë ka këto kompetenca:
 - 1.1. Të përgatitë seancat e Kuvendit dhe të zbatojë vendimet e tij;
 - 1.2. Të formulojë kërkesat dhe propozimet për Kuvendin;
 - 1.3. Të drejtojë punën e Akademisë në mes të seancave të Kuvendit;
 - 1.4. T'i propozojë dhe paraqesë Kuvendit propozimet e veta dhe propozimet e miratuara të sektioneve për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit;
 - 1.5. T'i miratojë propozimet e sektioneve për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit;
 - 1.6. Të marrë vendime rreth veprimtarisë botuese të Akademisë;
 - 1.7. Të zgjedhë udhëheqësit e projekteve shkencore dhe artistike me propozim të sektioneve;
 - 1.8. Të miratojë propozimet e sektioneve për kandidatët laureatë;
 - 1.9. Të caktojë ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm nga fushëveprimtaria e Akademisë;
 - 1.10. Të zgjedhë sekretarin e Akademisë;
 - 1.11. Të thërrasë seancat e Kuvendit;
 - 1.12. T'i paraqesë Kuvendit propozimin e planit dhe të programit të punës së Akademisë;
 - 1.13. Të caktojë delegacionet, grupet punuese dhe të zgjedhë përfaqësues të Akademisë;
 - 1.14. Të caktojë këshilla, komisione dhe grupe konsultative;
 - 1.15. Të përcaktojë propozimbuxhetin;
 - 1.16. Të nxjerrë rregullore, udhëzime administrative, urdhëresa dhe vendime që rregullojnë marrëdhënie të caktuara për Shërbimet profesionale, administrative dhe teknike;
 - 1.17. Të marrë vendime për çështje të vecanta që lidhen me realizimin e veprimtarisë së Akademisë, për të cilat nuk vendos Kuvendi i Akademisë;
 - 1.18. Kryesia punon në mbledhje;
 - 1.19. Vendimet në Kryesi merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj;
 - 1.20. Kryesia e Akademisë pas propozimit të sektionit përkatës, në bazë të përllogaritjeve

buxhetore dhe në bazë të përmasave të propozimeve të arritura, për secilën seancë zgjedhore merr vendim për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj, që zgjidhen, duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve; dhe

- 1.21. Të kryejë edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me këtë Statut.

Neni 33 Kryetari i Akademisë

1. Kryetari i Akademisë:
 - 1.1. Zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë;
 - 1.2. E udhëheq punën e Akademisë;
 - 1.3. E përfaqëson dhe e prezanton Akademinë;
 - 1.4. E udhëheq punën e Kryesisë dhe të Kuvendit të Akademisë;
 - 1.5. I nënshkruan të gjitha vendimet e Kryesisë dhe të Kuvendit;
 - 1.6. Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Akademisë; dhe
 - 1.7. Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë.

Neni 34 Nënkryetari i Akademisë

1. Nënkryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë dhe e zëvendëson Kryetarin e Akademisë në rast të mungesës së tij.
2. Nënkryetari i Akademisë kujdeset për zbatimin e konkluzioneve të Kryesisë dhe kryen punë të tjera, të cilat ia cakton Kryesia.

Neni 35 Sekretari shkencor i Akademisë

1. Sekretari shkencor i Akademisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt ose anëtarëve korrespondentë.
2. Sekretari shkencor i Akademisë:
 - 2.1. Bashkëpunon dhe bashkërendit veprimtarinë me sekretarët e seksioneve, me udhëheqësit e instituteve hulumtuese dhe qendrave studimore; dhe
 - 2.2. Organizon dhe bashkërendit veprimtarinë botuese të Akademisë.
3. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit shkencor, Kryesia me vendim të veçantë cakton ushtruesin e detyrës të Sekretarit shkencor.

VI. SHËRBIMET PROFESIONALE, ADMINISTRATIVE E TEKNIKE

Neni 36 Administrata e Akademisë

1. Shërbimet profesionale, administrative e teknike i kryen administrata e Akademisë.
2. Përveç funksioneve dhe përgjegjësive të caktuara me Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Administrata e Akademisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike dhe shërbimeve të tjera, përfshirë:
 - 2.1. Shërbimet për punën e seksioneve, instituteve hulumtuese dhe qendrave studimore të

- Akademisë;
- 2.2. Veprimtarinë botuese të Akademisë;
 - 2.3. Shërbimet e gjithmbarshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve e multimediale;
 - 2.4. Shërbimet e gjithmbarshme të dizajnit grafik;
 - 2.5. Shërbimet e përkthimit;
 - 2.6. Shërbimet e ndërlidhura me buxhetin, me pagesat, me auditimin e brendshëm, me prokurimin dhe me personelin;
 - 2.7. Shërbimet e menaxhimit të objektit, shërbimet teknike, pajisjen e zyrave, shërbimet për automjete, shërbimet postare, kujdesin kundër zjarrit dhe shërbimet e tjera të sigurisë; dhe
 - 2.8. Shërbimet e tjera që mund të përcaktohen nga Akademia.
3. Struktura organizative e Administratës së Akademisë përcaktohet nga Kryesia, pas propozimit të bërë nga Sekretari i Akademisë. Me miratimin e Kryesisë mund të themelohen ose të mbyllen departamente, sektorë ose njësi, kur kjo është e nevojshme për zbatimin efikas të funksioneve dhe të përgjegjësive të Administratës së Akademisë.
 4. Administrata e Akademisë do të ketë personel të nevojshëm për t'i mundësuar asaj të përbushë funksionet në mënyrë efektive dhe efikase, brenda resurseve buxhetore të ndara për Akademinë.
 5. Të punësuarit në shërbimet profesionale, administrative e teknike kanë statusin e nëpunësit civil, që rregullohet me legjislacionin për shërbimin civil dhe në mënyrë specifike me këtë Statut.
 6. Rregullat e përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil për rekrutimin e personelit, për pagat, për shtesat, për orarin e punës dhe për pushimet, zbatohen për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e Akademisë, të garantuar me Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve.

Neni 37

Sekretari i Akademisë

1. Sekretari i Akademisë është udhëheqës i administratës së Akademisë, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara në aktemërimin e tij që nënshkruhet nga Kryetari i Akademisë.
2. Sekretari i Akademisë është përgjegjës për:
 - 2.1. Administrimin e përgjithshëm dhe për menaxhimin e Administratës së Akademisë, si dhe për të siguruar se funksionet e caktuara të tij përbushen në mënyrë efektive dhe efikase;
 - 2.2. Të sigruar se vendimet e Kryesisë përkitazi me çështjet profesionale e administrative zbatohen brenda afateve kohore dhe në mënyrë efikase;
 - 2.3. Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve; dhe
 - 2.4. Organizimin dhe për plotësimin me personel të Administratës së Akademisë, për të sigruar se rekrutimi i personelit për Administratën e Akademisë është i bazuar në kualifikime profesionale, në aftësi dhe në merita dhe se ai bëhet me konkurs të drejtë e të hapur.
3. Sekretari i Akademisë zgjidhet nga Kryesia e Akademisë me konkurs publik.
4. Kushtet e konkursit i përcakton Kryesia e Akademisë.
5. Vlerësimi i performancës së Sekretarit të Akademisë bëhet në fund të çdo viti.

6. Sekretari i Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë.
7. Mandati i Sekretarit të Akademisë është për kohë të pacaktuar.

VII. FINANCIMI I AKADEMISË

Neni 38

Burimet financiare

1. Burimet financiare për punën e Akademisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Me mjetet nga Buxheti i Republikës së Kosovës mbështetet puna e seksioneve, instituteve hulumtuese, qendrave të tjera studimore të Akademisë, puna e organeve të qeverisjes së Akademisë, bashkëpunimi ndërkombëtar i Akademisë, veprimtaria e rregullt botuese e Akademisë, pasurimi i fondit të bibliotekës së Akademisë, shpërblimet e përhershme mujore të anëtarëve të rregullt dhe anëtarëve korrespondentë të Akademisë, shtesat për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi, pagat e përhershme mujore për të punësuarit në Shërbimet profesionale, administrative e teknike dhe të mirëmbajtjes të Akademisë.
3. Akademia mund të sigurojë mjete edhe nga donacionet, grantet e sponsorizimet dhe ato mjete mund t'i përdorë për veprimtarinë plotësuese të saj.
4. Akademia mund të sigurojë mjete të tjera plotësuese për punën kërkimore-shkencore e artistike të anëtarëve të saj të rregullt dhe të anëtarëve të saj korrespondentë përmes aktiviteteve të veta, marrëveshjeve të ndërsjella kërkimore-shkencore e artistike dhe përmes donacioneve, granteve e dhuratave sipas legjislacionit në fuqi.
5. Mjetet e Akademisë përdoren vetëm për dobi të Akademisë dhe për qëllime e detyra të përcaktuara me këtë Statut.

Neni 39

Pronësia e Akademisë

1. Akademia është pronare e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme që ka për kryerjen e veprimtarisë së saj.
2. Akademia është titullar i vetëm juridik që mund të marrë vendim për bartjen e të drejtave të saj pronësore.
3. Akademia është pronare e patundshmërisë që disponon (e godinës së Akademisë, e banesave, e ndërtesave dhe e pjesëve të ndërtesave), e bibliotekës, e koleksioneve shkencore e artistike dhe e gjësendeve të tjera, të cilat i ka siguruar nëpërmjet blerjes, dhuratave ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 40

Ndarja dhe destinimi i mjeteve financiare

1. Akademia në përputhje me qëllimet e caktuara, me planin financiar, i ndanë mjetet financiare për realizimin e detyrave të saj.
2. Mjetet e destinuara Kryesia e Akademisë mund t'i orientojë në mënyrë të mëvetësishme, pa marrë parasysh burimin e tyre.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Dispozitat kalimtare

1. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Akademia harmonizon organizimin, edhe aktet e tjera normative, me dispozitat e këtij Statuti.
2. Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë i kryejnë funksionet në të cilat janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij statuti, deri më kalimin e mandatit.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2 i datës 11 maj 2016.
4. Ky Statut hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të tij nga Kuvendi i Akademisë dhe nënshkrimit nga Kryetari i Akademisë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Akademik Mehmet Kraja

